

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti Për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, anëtarëve të trupit gjykues gjyqtarëve Berat Spahiu dhe Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarve B.N., nga fshati ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat S.R. nga ... dhe A.A., nga fshati ..., Komuna e ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat B.H., nga ..., për shkak të veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31, dhe veprës penale cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës nga neni 221 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I. nr. 24/2014, të datës 11.06.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 09.06.2016, bie dhe në prezence të palëve me datë 10.06.2016 publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

B.N., nga i ati S., dhe nëna S., e lindur S., i lindur ... në fshati ... Komuna e ... ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar në Shkollën Filllore “ ... ” në fshatin ... dhe këshilltar komunal, ka të kryer fakultetin e edukimit, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

A.A., nga i ati A., dhe nëna Y., e lindur A., i lindur ..., në ..., ndërsa me vendbanim në fshati ... Komuna e ..., i shkurorezuar, baba i 4. fëmijëve, i punësuar si mësimdhënës, dhe nga viti 2009 deri në vitin 2014 drejtor i kësaj shkolle, në shkollën fillore “ ... ” në ..., ka të mbaruar fakultetin filozofik dega letërsi dhe gjuhë shqipe, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPRK-ës,

LIROHEN NGA AKUZA

I

Se i pandehuri B.N., në cilësinë e Drejtorit Komunal të Arsimit në Gjilan, ka keqpërdorë pozitën dhe autoritetin zyrtar, me qëllim që ti shkaktoj dëm personit tjetër, ashtu që me datë 06.09.2013, duke vepruar në kundërshtim me nenin 70 par.2. të Ligjit të Punës, merr aktvendim për suspendim nga marrëdhënia e punës ndaj L.H., mësimdhënëse në shkollën fillore “ ... ” në ..., pa ndërmarrë as një veprim paraprak për vlerësimin e performancës së mësimdhënëses dhe këtë vendim të kundërligjshëm e zbaton A.A., drejtori i shkollës “ ... ” në

Me çka kishin me kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31, të KPRK-ës.

II.

Me aktvendimin e datës 06.09.2013, i pandehuri B.N., në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit, të Komunës së Gjilanit, ka suspenduar nga marrëdhënia e punës të dëmtuarën- mësimdhënësen L.H. nga ..., ndërsa i pandehuri A.A., ka ekzekutua vendimin e pa ligjshëm të pandehurit B.N., ashtu që në bashkëveprim kanë cenuar të drejtën e ushtrimit të detyrës pa zhvilluar kurrfarë procedure paraprake disiplinore.

Me çka kishin me kryer veprën penale cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës nga neni 221 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë PP/I. nr. 24/2014, të datës 11.06.2014, kundër të akuzuarve B.N., nga fshati ... dhe A.A., nga fshati ..., për shkak të veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31, dhe veprës penale cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës nga neni 221 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim merititor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Kadriu, në shqyrtimin gjyqësor fillimisht mbeti në tërësi pran aktit akuzues për veprat penale të cilat u vihen në barrë të akuzuarëve B.N. dhe A.A., keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31, të KPRK-ës, dhe veprës penale cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës nga neni 221 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare shtoi se vendimi mbi suspendimin nga marrëdhënia e punës e të dëmtuarës L.H. është nxjerrë në mënyrë jo ligjore e që më pas ky vendim është ekzekutuar dhe e njëjta nga shtatori i vitit 2013 është e pa punë. Konsiderojmë se fillimisht ka qenë dashtë që të krijohen kushtet në mënyrë që të vlerësohet puna e të dëmtuarës e më pas të vazhdohet me procedura tjera ligjore. Po ashtu konsiderojmë se prindërit e nxënësve nuk mund ta përjashtojnë arsimtarin nga puna porse shkolla ose drejtori i shkollës ka qenë dashur që shqetësimet e më hershme ti bart tek Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe tek inspeksioni në mënyrë që të bëhet vlerësimi i punës së të dëmtuarës L.H.. Andaj, propozoi që të akuzuarit të shpellen fajtor dhe të dënohen me dënim merititor sipas KPRK-ës e po ashtu propozon që të merren parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

E dëmtuara L.H., fillimisht i është bashkangjitur ndjekjes penale ndaj të akuzuarve si dhe ka ushtruar kërkesë pasuroro juridike, përderisa në cilësinë e dëshmitares deklaroi se unë në shkollën fillore “ ... ” punoi që nga viti 1991, dhe se me rastin e fillimit të vitit shkollor përkatësisht me datë 02.09.2013, unë sipas shortit kam marrur listën e nxënësve dhe me atë rast kam hyrë në klasën e I/6, ku në klasë ishin vetëm katër nxënës me prindërit e tyre deri sa në listë kam pasur 26 nxënës. Nxënësit kanë qenë në oborrin e shkollës dhe nuk kanë hyrë në klasë, ashtu që kam dalë dhe i kam ftuar me emër dhe mbiemër, porse të njëjtit kanë refuzuar të hyjnë në klasë. Pasi

që nxënësit së bashku me prindërit kanë refuzuar të hyjnë në klasë unë me kërkesën e prindërve e kam njoftuar drejtorin me të cilin kemi dalur në oborrin e shkollës dhe ju kemi drejtuar nxënësve dhe prindërve të tyre që të hyjnë në klasë dhe të bisedojmë por prindërit prapë kanë refuzuar, dhe në oborrin e shkollës kanë qëndruar deri në ora 17,00 h, e po ashtu edhe nxënësit që ishin në klasë me prindërit e tyre kanë dalur dhe i janë bashkangjitur nxënësve tjerë. Po ashtu edhe të nesërmen me datë 03.09.2013, kam shkuar në shkollë sipas orarit të përcaktuar, por përsëri nxënësit kanë refuzuar të hyjnë në klasë. Me datë 04.09.2013, asnjëri nga nxënësit nuk ka hyrë në klasë por kanë qëndruar në oborrin e shkollës, dhe kur unë i kam njoftuar për të hyrë në klasë, të njëjtit kanë thënë se nuk hyjmë në klasë pa lejen e drejtorit. Edhe përkundër sqarimeve të mija prindërve se unë kam 20 vite përvojë pune dhe fillimisht të fillojmë e më pas të vlerësohen aftësitë e mija, përsëri të njëjtit kanë refuzuar të hyjnë në klasë. Po ashtu me datë 05.06.2013 jam paraqitur në punë, nxënësit kanë refuzuar të hyjnë në klasë e diku rreth orës 15:00 të datës 06.09.2013, drejtori më ka ftuar dhe më ka dhënë një zarf ku kishte qenë aktvendimi për suspendimin tim nga puna për 6 muaj. Edhe përkundër vendimit për suspendim unë përsëri jam paraqitur në punë dhe nxënësit po ashtu kanë refuzuar të hyjnë në klasë. Një ditë më pas në shenjë përkrahje arsimtarët e kësaj shkolle kanë bojkotuar mësimin. Pas një periudhe prej dy jave ka ardhur një mësuese tjetër dhe atëherë nxënësit kanë hyrë brenda të klasë deri sa unë kam qëndruar në sallën e arsimtarëve. Para se të vijë arsimtarja tjetër unë kam takuar drejtorin e DKA –së (Drejtoria Komunale e Arsimit) dhe kam kërkuar nga i njëjti sqarim se pse të largohem nga puna pas kaq vite përvojë pune dhe kam kërkuar një zgjidhje, i njëjti më është drejtuar me fjalët se ju nuk e njihni lëndën e matematikës dhe duhet të shkoni në një shkollë tjetër në “ ... ”, por edhe më ka propozuar të punoi në bibliotekën e qytetit. Unë kam refuzuar që të shkoj në shkollën tjetër ngase shkollën fillore “ ... ” e kam më afër. Pas ardhjes së drejtorit të ri të DKA –së, duku në gjysmë vjetorin e dytë, porse edhe drejtori i ri N.M. më ka thënë që unë të punoi në bibliotekë deri sa të bëhet një zgjidhje tjetër, por unë kam refuzuar dhe më është lëshuar në rekomandim që të kthehem në vendin e punës. Është e vërtetë se drejtori pas marrjes së rekomandimit më ka ftuar në zyrën e tij për konsultime për ngritjen e cilësisë mësimore ashtu që unë kam ndjekur kurset e trajnimeve dhe jam pajisur me certifikata. Lidhur me këtë çështje është duke u zhvilluar procedurë për kthimin tim në vendin e punës çka Gjykata e shkollës së parë ka aprovuar kërkesë padinë time, deri sa lënda është në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Dëshmitari B.S. deklaroi se e dëmtuara L.H. është suspenduar me datë 06.09.2013, mbi bazën e informatave të mara nga drejtori i shkollës fillore “ ... ” si dhe nga informata e prindërve të nxënësve të klasa I/6, të cilët i janë ndarë mësueses L.H., e të cilët kanë ardhur në DKA –së të gjithë prindërit dhe kanë theksuar se nuk dëshirojnë që L.H. të jetë mësuese e fëmijëve të tyre. Pas 3-4 ditëve më ka ftuar ish

drejtori i DKA-së B.N. në mënyrë që të ia përgatisja një kontratë pune për sistemimin e L.H. në bibliotekën e qytetit pasi që unë isha shef i Sektorit Juridik në DKA. Me atë rast unë kam përgatitur kontratën e punës si bibliotekistë në Bibliotekën e Qytetit si dhe një aktvendim për sistemim dhe të njëjtat ia kam dorëzuar drejtorit B.N.. Deri sa unë kam qenë ushtrues detyre i DKA, për muajin dhjetor 2013 dhe janar 2014, në zyrën time ka ardhur e dëmtuara L.H. dhe ka kërkuar që të sistemohet si mësuese në klasën I/6, dhe më ka thënë se L. e kishte refuzuar vendin e punës së bibliotekistës. E kam njoftuar se prindërit e nxënësve të kësaj klase kanë qenë në DKA dhe janë kategorik që mësimi mos të lejohet me arsimtaren L.H., dhe i kam rekomanduar që të pranoi vendin e punës bibliotekiste deri sa të rregullohet çështja e kthimit në shkollën “ ... ” porse e njëjta përsëri ka refuzuar. Komisioni disiplinor në kuadër të DKA-së ka rekomanduar që e njëjta të kthehet në paralelen I/6, dhe njëkohësisht inspektorët rajonal të arsimit të bëjnë hospitimin e disa orëve mësimore tek arsimtarja L. me qëllim të vlerësimit të punës së saj.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.N., avokat S.R., në fjalën përfundimtare deklaroi: se i mbrojturi im B.N. është akuzuar për dy vepra penale edhe atë keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK si dhe veprës penale cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës nga neni 221 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, por nga procesi gjyqësor i zhvilluar dhe shtjellimi i provave me asnjë provë të vetëm nuk është vërtetuar se i njëjti të ketë ndërmarr veprime inkriminuese në drejtim të kryerjes së këtyre vepra penale. Nga mbrojtja e të akuzuarit B., provave tjera të administruara e në veçanti nga deklarata e vet të dëmtuarës L.H. nuk është vërtetu se i njëjti ti ketë kryer veprat penale si në aktakuzë. Mbrojtja e të akuzuarit ishte bindëse e logjikshme dhe nuk është kundërshtuar me asnjë provë të shtjelluar. Nuk është kontestues fakti se në cilësi të drejtorit të DKA-së në Gjilan në atë kohë të ketë marr veprime konkrete me qëllim të sanimit të gjendjes së krijuar - bojkotit 5-së (pesë) ditor të punës ashtu që prindërit me fëmijët e tyre kishin refuzuar të hynin në klasë në mënyrë që klasën mos ta drejtonte e dëmtuara L.H.. Në veprimet e të akuzuarit B. nuk është vërtetuar se dikush ka fituar ose të ketë ndërmarrë i njëjti veprime që ti shkaktoheshin dëm tani të dëmtuarës. Këto veprime i akuzuari i kishte ndërmarrë për të tejkaluar situatën e krijuar në shkollë dhe për fillimin e mbarë të vitit shkollor edhe për kundër përpjekjeve që kishte bërë, duke biseduar me të dëmtuarën edhe prindërit e nxënësve, ashtu që kishte qenë i detyruar që në kuadër të kompetencave të tija të marr vendim për suspendim të përkohshëm edhe atë me 50% (pesëdhjetë për qind) dhe krejt këtë pasi që ishte përpjekur që ta bind të dëmtuarën që të kaloj në paralelen e shkollës së njëjtë edhe atë përkohësisht. Po ashtu të njëjtës i ka ofruar edhe vendin e punës në bibliotekë të shkollës e më pas edhe në bibliotekën e qytetit porse e njëjta kishte refuzuar për çka edhe vet ka deklaruar në këtë Gjykatë. Nga të cekurat e theksuara

më lartë dhe në mungesë të provave propozojmë gjykatës që lidhur me të akuzuarin B.N. të marrë aktgjykim lirues.

I akuzuari B.N., në mbrojtjen e tij deklaroi se drejtor i DKA-së në Gjilan jam emëruar me datë 02.05.2010, ashtu që në fillim të vitit shkollor 2013-2014, së bashku me Komitetin për Arsim në Gjilan që nxënësit të regjistroheshin nëpër klasë më sistem kompjuterik në mënyrë që të barazohen, ashtu që emrat e nxënësve janë futur nëpër zarfe dhe zarfet i kanë tërhequr arsimtarët. Në fillim të viti shkollor 2013 drejtori i shkollës më ka informuar se nxënësit dhe prindërit po refuzojnë të hyjnë nëpër klasa, për gjysmë ore nxënësit së bashku me prindërit kanë ardhur në DKA (Drejtorinë Komunale të Arsimit), kam biseduar me prindërit në mënyrë që ti bind të kthehen në shkollë, më pas inspektorët ta verifikojnë mësuesen L.H., e më pas të merret një vendim i përbashkët. Pra kështu ka krijuar e kam ftuar shefin e personelit B.S. në mënyrë që të gjendet një zgjidhje nga aspekti juridik ashtu që kemi marrë një vendim për suspendim me pagesë pre50% në afat pre 6 muajve. Pas marrjes së këtij vendimi një arsimtare e kemi sjellë në shkollën fillorë “ ... ” ndërsa arsimtares L. i kemi ofruar vendin e punës në Bibliotekën e Qytetit si bibliotekiste. Paraprakisht para marrjes së vendimit për suspendim më L. ka biseduar drejtori i shkolle A.A. me ç’rast i ka propozuar që të marr një paralele në lagjen e 2(dytë) e cila ka funksionuar në kuadër të shkollë “ ... ”, por të njëjtën nga ana e drejtorit i është ofruar edhe vendi i punës së bibliotekistes në këtë shkollë (...). Me ardhjen e arsimtares tjetër në shkollën ... është normalizuar gjendja çka ka qenë edhe qëllimi i marrjes së aktvendimit për suspendim. Pas përfundimit të mandatit tim si drejtor në DKA(Drejtorinë Komunale të Arsimit), Komisioni Disiplinor ka vendosur që e njëjta të kthehet në vendin e punës dhe ka rekomanduar DKA-së për një gjë të tillë por që prindërit përsëri kanë vendosur ta kundërshtojnë kthimin e saj në punë. Ofertat që i janë ofruar për punë kanë qenë serioze dhe për këtë ka qenë i njoftuar edhe babai i vet të dëmtuarës, po ashtu e njëjta kategorikisht e ka refuzuar atë. Andaj dua të shtoj se nuk kam pasuar kurrfarë tendence për të dëmtuar L.H. por krejt kjo ka ndodhur në mënyrë që të normalizohet procesi mësimor dhe mbarëvajtja e mësimin dhe për gjithë këtë fajtor është vet e dëmtuara nga se nuk ka pasur nxënës përkatësisht është bojkotuar nga nxënësit dhe prindërit e tyre. Andaj nuk e ndiej veten fajtor dhe nuk kam pasur asnjëherë për qëllim as ndaj të dëmtuarës e as ndaj dikujt tjetër ashtu që propozoj të lirohem nga Aktakuza

Mbrojtësi i të akuzuarit A.A., avokat B.H., në fjalën përfundimtare deklaroi: gjatë shqyrtimit gjyqësorë me administrimin e të gjitha provave të propozuara është bërë dëgjimi i të dëmtuarës, të akuzuarit si dhe dëshmitari B.S.. I cili në mënyrë shumë të qartë ka bërë të ditur se i akuzuari A.A. si drejtor shkolle nuk ka qenë kompetent të merr Aktvendim për suspendim por aktvendimet i merr organi i punësimit, i mbrojturi i im A.A. ashtu siç kemi theksuar edhe më parë të gjitha veprimet i ka ndërhyrë brenda autorizimeve ligjore si drejtor shkolle. Sipas neni 422 i

KPRK-së qëllimi është element thelbësorë i kësaj vepre penale. Konsiderojmë që qëllimi me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari A.A. ka pasur për qëllim ta keqpërdori pozitën e ti apo të i cenoj të drejtën e marrëdhënies se punës askujt e aq më pak tani te dëmtuarës L.H.. Meqenëse prokuroria nuk ka arritur që gjykatës te i paraqes prova të mjaftueshme dhe bindëse me të cilën do të vërtetohej teza e akuzës, nga gjykata kërkohet që të akuzuari A.A., bazuar në nenin 364 paragrafi 1.3 të KPPRK-së ta liroj nga akuza sepse nuk është provuar se i akuzuari A. ti ketë kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë.

I akuzuari A.A., në fjalën përfundimtare deklaroi: se në pozitën e Drejtorit të shkollës fillore “ ... ” kam qenë nga 15 Shtatori 2010 dhe këtë pozitë e kam mbajtur deri me datë 15.09.2014 e më pas kam vazhduar si mësimdhënës në të njëjtën shkollë. Detyrat e drejtorit të shkollës kanë qenë të përcaktuara me Ligj për Arsimin fillor dhe të mesëm dhe me Rregulloren e Punës të përcaktuar nga DKA, pra kam pasur për detyrë organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit mësimor. Sa i përket L.H. kur unë jam zgjedhur drejtor e njëjta ka qen duke punuar aty, deri sa lidhur me rastin, në Shtator me rastin e fillimit të vitit shkollor nga DKA, kemi marr njoftimin që nxënësit të sistemohen sipas sistemi kompjuterik, emrat e tyre të futen në zarfe të mbyllën e më pas zarfet të tërhiqen nga ana e arsimtareve. Pas tërheqjes së zarfeve mësuese L.H. i ka rënë klasa I/6, ashtu që të gjithë arsimtarë i kane futur nxënësit në klasa sipas shortit ashtu që prindërit dhe nxënësit që i janë ndarë L.H. kanë refuzuar të hyjnë në klasë. Kam dalë dhe kam biseduar me prindërit dhe më pas të gjithë prindërit kanë ardhur në zyrën time dhe kanë thënë se nuk mund të jetë mësuese së fëmijëve të tyre L.H., ngase mësuesja në fjalë nuk është e aftë për mësim dhënie e posaçërisht në shkencat ekzakte. Kam kërkuar që përsëri nxënësit të futen në klasë dhe kërkesat e tyre të drejtohen në DKA por prindërit kanë refuzuar kategorikisht. Të nesërmen prindërit kanë dorëzuar një kërkesë në sekretarin e shkollës që fëmijëve të tyre të u caktohen një mësuese tjetër ashtu që në kërkesën e kam drejtuar në DKA, ashtu që kam kërkuar që nxënësit dhe prindërit të futen në klasë përsëri. Kështu ka vazhduar për 4 (katër) ditë rresht deri më datë 09.09.2013 kam marrë një vendim me të cilën figuronte se L.H. të suspendohet ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, deri sa të zgjidhet çështja përkatësisht tejkalohet situata. Një kopje të vendimit ia kamë dorëzuar L. dhe në shkollë është transferuar për periudhën 6 (gjashtë) muaj një arsimtare tjetër, dhe mësimi me atë rast është normalizuar Pra vendimi për neve ka qenë i obligueshmen çka unë si drejtor shkollë kam pasur për obligim ta zbatoj dhe kam vepruar plotësisht mbi bazë ta autorizimeve të mija. Derisa ka qenë ushtruese detyre i drejtorit të DKA-së, B.S. kam marrë një urdhëresë në formë të shkruar që mësuesja L. të filloj mësimin për një muaj ditë me paralelen I/6 por që kjo nuk ka mundur të realizohet pasi të nxënësit së bashku me prindërit e tyre kategorikisht kanë refuzuar që mësuesja L.H. mos ta udhëhiqi atë klasë duke u drejtuar më një shkresë me nënshkrimet e tyre. Atë dite nuk është mbajtur mësimi dhe unë për këtë e kam

informuar ushtruesin e DKA-së. Vlen të theksohet se para fillimit të vitit shkollor 2013-2014 mësuesja L. dhe një mësuese tjetër janë marrë vesh që të i ndërrojnë vendet e punës ashtu që mësuesja L. të shkojë në lagjen e II (dytë), (paralele e shkollës “ .. ”), por ashtu nuk ka ndodhur dhe unë kam bërë të gjitha përpjekjet që e njëjta të mos mbetet pa vend pune duke i ofruar vendin e punës bibliotekistë ne bibliotekën e shkollës por të njëjtës iu është ofruar edhe vendi i punës bibliotekistë ne Bibliotekën e Qytetit. Andaj duke qenë se nuk është vërtetuar që unë të i kem kryer veprat penale, dhe se e gjithë përpjekja e ime ka qenë tejkalimi i situatës së krijuar, i propozoj Gjykatës që të më liroi nga përgjegjësia penale.

Gjykata bëri shtjellimin dhe analizimin e provave materiale: licenca e mësimdhënësit lëshuar në emër të të dëmtuarës L.H., nr. ... e datës 11.09.2012, diploma e fakultetit e datës 15.08.2011, rekomandimi për drejtorin e DKA, lëshuar nga Komisioni Disiplinor i datës 14.01.2014, kërkesa për zbatim të rekomandimit e datës 15.01.2014, njoftimi nga inspektori i punës nr. ... e datës 20.12.2013, kërkesa e prindërve e datës 02.09.2013, ankesa e prindërve e datës 02.09.2011, kërkesë e prindërve e datës 02.09.2011, kërkesë e prindërve e datë 02.09.2011 drejtuar drejtorit të shkollës.

Pas shtjellimit dhe analizimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK gjykata konstatoi këtë gjendje faktike se me rastin e fillimit të vitit shkollor 2013-2014, me rastin e ndarjes së nxënësve të klasave të para nëpër paralele sipas sistemit kompjuterik me ç ‘rast janë përcaktuar emrat e nxënësve dhe janë futur në zarfe e më pas zarfet janë tërhequr nga mësimdhënësit të krasëve të para, mësueses L.H. sipas zarfit i ka takuar klasa e I/6. Më pastaj pasi që është bërë ndarja e nxënësve nëpër klasa e paraleleve tjera me mësuesit e tyre kanë hyrë nëpër klasë përderisa nxënësit e paraleles së kl. I/6, sikundër edhe prindërit e tyre kanë refuzuar që të hyjnë në klasë. E dëmtuara L.H. i kishte ftuar nxënësit që të hyjnë në klasë, por nxënësit me prindërit e tyre kishin refuzuar një gjë të tillë, më pas e dëmtuara për këtë fakt e kishte njoftuar drejtorin e shkollës tani të akuzuarin A.A, me ç ‘rast edhe drejtori i kishte ftuar nxënësit të cilët ishin me prindërit e tyre të futen në klasë por prapë të njëjtit kishin refuzuar. Më pas prindërit kishin shkuar në zyrën e drejtorit të shkollës dhe e kishin njoftuar drejtorin që nuk dëshirojnë që mësuese për fëmijët e tyre të ishte e dëmtuara L.H., me arsyetim se është e paaftë në shkencat ekzakte. Një gjendje e këtillë kishte vazhduar edhe me 4. ditë me radhë deri me datë 06.09.2013, ku nxënësit dhe prindërit e tyre kategorikisht kishin refuzuar që të futen në klasë dhe për këtë çështje drejtori i shkollës e kishte informuar Drejtorin Komunale të Arsimit në Gjilan. Drejtori i shkollës edhe përkundër përpjekjeve nuk kishte arritur që të i bindte nxënësit dhe prindërit e tyre, edhe pse ju kishte thënë se fillimisht le të filloi procesi mësimor e më pastaj do të bëhet vlerësimi i mësimdhënëses nga ana e inspektorët, prapë se prapë nuk kishte arritur të i bind dhe

procesi mësimor kishte mbetur pa filluar. Për shkak të gjendjes së krijuar përkatësisht refuzimit të nxënësve dhe prindërve të tyre që mësimdhënëse e asaj klase-paralele mos të jetë e dëmtuara, drejtori i DKA-së në Gjilan tani i akuzuari B.N., pas konsultimit me shefin e personelit kishte marrë Aktvendim për suspendimin e të dëmtuarës L.H. për 6 muaj me pagesë prej 50% të pagës, deri në normalizimin e procesit mësimor. Paraprakisht para marrjes së aktvendimit të dëmtuarës L.H. i ishte propozuar që e njëjta të kaloi në vendin e punës si mësuese në lagjen e dytë e cila ka qenë në kuadër të shkollës fillore "...", e më pas drejtori i shkollës i kishte ofruar edhe vendin e punës të bibliotekistes në shkollë, por e dëmtuara kategorikisht kishte refuzuar një gjë të tillë. Më pas të dëmtuarës i ishte ofruar edhe vendi i punës si bibliotekiste në bibliotekën e qytetit, por e njëjta po ashtu kishte refuzuar. Pas marrjes së aktvendimit për suspendim dhe marrjes së paraleles së klasës I/6, nga një mësuese tjetër, procesi mësimor në shkollë ishte normalizuar dhe mësimi në paralelen e klasës I/6 kishte filluar. Me atë rast të dëmtuarës L.H. ju ka lëshuar edhe Aktvendimi për suspendimin nga vendi i punës. Kundër këtij aktvendimi e dëmtuara kishte ushtruar ankesë në DKA në Gjilan, ashtu që më pas komisioni disiplinor i këtij Drejtorati me datë 14.01.2014, kishte nxjerrë rekomandim që e dëmtuara të kthehet në vendin e punës mësimdhënëse në klasën I/6 në shkollën fillore "...". Derisa, mandati i drejtorit të DKA në Gjilan tani të akuzuarit B.N. i kishte skaduar me datë 20.12.2013. Ushtruesi i atëhershëm i detyrës së DKA B.S., me parashtresë ju kishte drejtuar drejtorit të shkollës "S.H." që të zbatohet rekomandimi i datës 14.01.2014. Sipas rekomandimit të theksuar më lartë e dëmtuara ishte paraqitur në punë, porse përsëri nxënësit dhe prindërit e tyre kategorikisht kishin refuzuar që të vazhdohet procesi mësimor me mësuesen tani të dëmtuarën edhe përkundër insistimit të drejtorit të shkollës që mësimi të vazhdoi me mësuesen tani të dëmtuarën, ashtu që rekomandimi nuk kishte mundur të zbatohet për shkak të refuzimit të prindërve që mësuese e fëmijëve të tyre të jetë e dëmtuara L.H.. Më pas e dëmtuara kishte ushtruar padi në këtë Gjykatë për kthimin e saj në punë ashtu që me aktgjykimin C.nr. 796/2013 të datës 14.07.2015 është aprovuar kërkesë padia e saj e tani lënda sipas ankesës gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Nga një gjendje e këtillë e konstatuar faktike nuk është kontestues fakti se është marr aktvendim për suspendimin e të dëmtuarës nga puna Luljeta Hoxha, në kohëzgjatje prej 6 muaj me 50% të pagës, por me asnjë provë të vetme nuk është dëshmuar që të akuzuarit Bujar Nevzadi dhe Ahmet Aliu, të kenë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë. Për të ekzistuar vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KPRK-ës, duhet që personi zyrtar të i tejkaloji kompetencat e tija ose mos të i përmbushi detyrat zyrtare me qëllim që të përfitoi çfarëdo dobie për vete apo personit tjetër, apo të i shkaktoi dëm personit tjetër, ose të i shkel të drejtat e personit tjetër. Në rastin konkret me asnjë fjalë të vetme nuk është

thënë se të akuzuarit B.N. dhe A.A., me rastin e marrjes së aktvendimit për suspendim të kenë realizuar çfarëdo dobie për vete apo për personin tjetër. Po ashtu nuk është vërtetuar qëllimi që të njëjtit të i shkaktojnë dëm personit tjetër – tani të dëmtuarës L.H. Se një qëllim i tillë nuk ka ekzistuar vërtetohet me faktin se pas marrjes së aktvendimit nga ana e Drejtorit të DKA tani të akuzuarit B.N. e edhe paraprakisht të njëjtës i është ofruar vend tjetër pune me pagë të njëjtë si në shkollën në lagjen e dytë, e po ashtu edhe vendi i punës si bibliotekistë në shkollën fillore “ ... ” si dhe vendi i punës së bibliotekistës në Bibliotekën e Qytetit. Se refuzimi i nxënësve dhe prindërve ishte arsyeja për marrjen e aktvendimit për suspendim vërtetohet edhe me faktin edhe pas skadimit të mandatit të drejtorit të DKA-së tani të akuzuarit B.N. dhe marrjes së rekomandimit nga Komisioni Disiplinor, ky rekomandim nuk ka mundur të zbatohet pikërisht nga arsyeja se prindërit dhe nxënësit kishin refuzuar që mësimi të vazhdoi me mësuesen – të dëmtuarën L.H.. Sa i përket të akuzuarit A.A., kompetencat e tija nuk kanë qenë në nxjerrjen e vendimeve, por detyrë e drejtorit të shkollës është ekzekutimi i vendimeve të cilat i nxjerr Drejtoria Komunale e Arsimit. Fakti se të dëmtares Luljeta Hoxha me rastin e fillimit të vitit shkollor nxënësit dhe prindërit e tyre kanë refuzuar të hyjnë në klasë nuk e konteston edhe vetë e dëmtuara L.H. por vërtetohet edhe me kërkesën e prindërve të dt. 02.09,2013. Po ashtu e dëmtuara nuk e konteston as faktin se të njëjtës i është ofruar vendi i punës në shkollën fillore në lagjen e II, sikundër edhe në Bibliotekën e shkollës e edhe në Bibliotekën e Qytetit e për ta pranuar vendin e punës në bibliotekë i kishte thënë edhe drejtori pasues i DKA N.M.. Edhe dëshmitari B.S. nuk e konteston faktin se është ftuar në drejtori i DKA-së që me rastin konkret të refuzimit nxënësve dhe prindërve të tyre që mësimi të zhvillohet me mësuesen tani të dëmtuarën të gjendet një zgjidhje, ashtu që më pas është marr aktvendim për suspendim e po ashtu dëshmitari e konfirmon edhe faktin se pas marrjes së rekomandimit që nga Komisioni i ankesa që mësuesja të kthehet në vendin e punës, ky rekomandim nuk ka mundur të zbatohet për shkak të refuzimit të prindërve dhe nxënësve.

Sa i përket veprës së dytë penale cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës nga neni 211 të KPRK-ës, për të cilën të akuzuarit akuzohen kjo veprë penale është konsumuar me veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KPRK-ës, pasi që vepra penale e keqpërdorimit është veprë penale më e rëndë ashtu që në mungesë të elementeve për të ekzistuar vepra penale e keqpërdorimit në veprimet e të akuzuarve nuk janë gjetur elemente të veprës penale cenimi i drejtave në marrëdhënien e punës.

Andaj në mungesë të provave me të cilat do të vërtetohej se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen dhe bazuar në nenin 364 u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 454, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 116/14 Me datë. 10.06.2016**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*